

VENDIM
Nr. 774, datë 19.12.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 11, DATË 11.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APELIMEVE TATIMORE, PËRBËRJEN, KRYESIMIN, SEKRETARIATIN, NDRYSHIMIN E ANËTARËVE DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË TYRE, TË PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT E TË VENDIMMARRJES, SI DHE PËRCAKTIMIN E KUFIRIT TË VLERËS OBJEKT SHQYRTIMI I KOMISIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, pika 3, dhe 108, pika 7, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 11, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të funksionimit të Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore, përbërjen, kryesimin, sekretariatit, ndryshimin e anëtarëve dhe masën e shpërblimit të tyre, të procedurave të shqyrtimit të ankimit e të vendimmarrjes, si dhe përcaktimin e kufirit të vlerës objekt shqyrtimi i komisionit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2.2 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e parë, fjalët “... jo më shumë se 2 mandate ...” hiqen.

b) Pas fjalisë së katërt shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht rasteve të parashikuara në pikën 2.5 të këtij vendimi, anëtari ekzistues, në rastin e përfundimit të mandatit, vijon të ushtrojë funksionet si anëtar i KSHAT-së deri në emërimin e anëtarit të ri, por jo më shumë se 3 (tre) muaj.”.

2. Në pikën 2.3, pas fjalëve “... 2 vjet eksperiencë ...” shtohen fjalët “... si avokat ...”.

3. Në pikën 3.1, shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) raporton për ecurinë e veprimtarisë së KSHAT-së pranë ministrit të Financave brenda muajit janar të vitit pasardhës ose sa herë i kërkohet prej tij.”.

4. Në fjalinë e dytë të pikës 4.1, fjalët “... 7 (shtatë) ditë pune ...” zëvendësohen me “... 5 (pesë) ditë pune ...”.

5. Në fund të pikës 4.2 shtohen fjalët “..., në format elektronik ose shkresor”.

6. Në pikën 4.3, fjalët “... shumica e anëtarëve të tij ...” zëvendësohen me “... të paktën 5 (pesë) anëtarë ...”.

7. Në pikën 4.4, fjalia e parë shfuqizohet.

8. Pika 5.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.2. Drejtori i Drejtorisë së Apelit, brenda 3 (tri) ditëve punë nga paraqitja e kërkesës, në rast se detyrimet objekt ankimi janë mbi shumën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, njofton kryetarin e KSHAT-së dhe ia përcjell ankimin administrativ sekretariatit të Komisionit të Shqyrtimit të Apelit Tatimor. Kryetari, në rrugë elektronike, cakton relatorin dhe njofton sekretariatit brenda 3 (tri) ditëve punë.”.

9. Fjalia e dytë e pikës 5.5 shfuqizohet.

10. Pas pikës 5.12 shtohet pika 5.13, me këtë përmbajtje:

“5.13. Zbatimi i vendimit të KSHAT-së nga administrata tatimore apo kundërshtimi i tij në gjykatë nga tatimpaguesi bëhen në përputhje me përcaktimet e ligjit për procedurat tatimore. KSHAT-ja përfaqësohet në gjykatë nga strukturat e administratës tatimore.”.

11. Në pikën 6.1, fjalët “... 20 000 (njëzet mijë) lekë ...” zëvendësohen me “... 40 000 (dyzet mijë) lekë...”.

12. Pika 6.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6.2. Çdo anëtar i sekretariatit të KSHAT-së merr një shpërblim në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.

II. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama